

FINANCA

BULETINI MUJOR | JANAR 2025



MINISTRI MALAJ MBLEDH KËSHILLIN TATIMOR, DISKUTOHET MBI AKTET NËNLIGJORE NË FUQI TË LEGJISLACIONIT FISKAL

Nën drejtimin e Ministrit të Financave, Petrit Malaj, u zhvillua mbledhja e radhës e Këshillit Tatimor, me qëllim diskutimin mbi aktet nënligjore në fuqi të legjislacionit fiskal dhe analizimin e përputhshmërisë së këtyre akteve me ligjet fiskale. Ministri Malaj vlerësoi kontributin e dhënë nga Këshilli Tatimor sa i përket Strategjisë

Afatmesme të të Ardhurave dhe shprehu angazhimin për vijimin e bashkëpunimit në funksion të diskutimit të çështjeve të politikës fiskale, administrimit tatimor dhe doganor. Në Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave është përcaktuar se në katër vitet e ardhshme fokusi do të jetë analizimi plotë i politikës tatimore në vend dhe vlerësimi i çdo përjashtimi tatimor apo norme të reduktuara. Ministri Malaj theksoi se ky analizim do të bëhet jo vetëm në aspektin e sasisë së të ardhurave të munguara në buxhet, por të efekteve në zhvillimin e një sektori dhe në sektorët e tjerë që ndërveprohen.

LEXO MË SHUMË

KUVENDI MIRATON AKTIN NORMATIV PËR NDRYSHIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancë plenare Aktin Normativ nr. 5 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", i ndryshuar, i cili fillimisht u paraqit para deputetëve nga Ministri i Financave, z. Petrit Malaj. Në fjalën e tij, Ministri Malaj u shpreh se përmes Aktit Normativ synohet ruajtja e pandryshuar e nivelit të planifikuar të deficitit buxhetor, ruajtja e pandryshuar e nivelit të

të ardhurave të përgjithshme dhe rishpërndarja e rreth 50 miliardë lekëve, mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korentë e kapitale, me synim realizimin sa më të plotë të shpenzimeve publike për vitin 2024. Ministri theksoi faktin se ndryshimet e propozuara do të vijojnë të sigurojnë stabilitetin e parametrave kyç makro-fiskalë e buxhetorë, ndërsa do të vijojë garantimi i trajektores rënëse të nivelit të borxhit publik në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto.

LEXO MË SHUMË



Administrata Tatimore

INFORMALITETI I PAGAVE

143.000

punonjësve u është rritur paga me më shumë se 10% krahasuar me shtator 2024 (para aksionit)

+28% MË SHUMË KONTRIBUTE DHE TAP TË PAGUARA

Sektori që ka rritur më shumë pagat: **SHËRBIMI**

www.tatime.gov.al

ANËTARËSIMI NË BE, MIRATOHET PROGRAMI I REFORMAVE EKONOMIKE 2025-2027

Programi i Reformave Ekonomike 2025-2027:

Angazhimet me reformat kryesore që Shqipëria do të ndërmarrë në periudhën afatmesme

Këshilli i Ministrave ka miratuar Programin e Reformave Ekonomike (ERP) 2025-2027, i cili do t'i dërgohet më pas Komisionit Europian, në kuadër të angazhimeve që Shqipëria ka si vend kandidat për anëtarësimin në

Bashkimin Europian. ERP paraqet statusin e zbatimit të rekomandimeve nga Përfundimet e Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, kuadrin makroekonomik dhe fical, që synojnë të mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomike, inovacionin dhe konkurrueshmërinë. Programi ERP për periudhën 2025-2027 ka për qëllim të paraqesë planin ekonomik, makroekonomik, fiskal, buxhetore, monetar e financiar, si dhe angazhimet me reformat kryesore që Shqipëria do të ndërmarrë në periudhën afatmesme në vijim, të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë ose indirekt mbi zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit.

LEXO MË SHUMË

MINISTRI MALAJ PREZANTON NË KOMISIONIN E EKONOMISË DHE FINANCAVE AKTIN NORMATIV PËR NDRYSHIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024



Ministri i Financave, Petrit Malaj, prezantoi në komisionin parlamentar për Ekonominë dhe Financat aktin normativ nr. 5, datë 19.12.2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2023 "Për

buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar. Gjatë fjalës së tij, Ministri Malaj u shpreh se përmes aktit normativ u synua kryesisht mbështetja për shtresat më vulnerabël të shoqërisë, përmes një pakete prej rreth 2.2 miliardë lekë, si dhe krijimi i një llogarie speciale në Bankën e Shqipërisë për mbështetjen e pensionistëve, me një transfertë fillestare prej rreth 6.3 miliardë lekë. Ministri theksoi faktin se ndryshimet e propozuara në këtë akt do të vijojnë të sigurojnë stabilitetin e parametrave kyç makro-fiskal e buxhetorë, krahas garantimit të trajektores rënëse të nivelit të borxhit publik në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto.

LEXO MË SHUMË

LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT TË PAGAVE, REZULTATE POZITIVE NË DEKLARIMIN E PAGËS REALE DHE NË RITJEN E PAGESËS SË KONTRIBUTEVE

Aksioni i Administratës Tatimore kundër Informalitetit të Pagave ka sjellë rezultate domethënëse, duke ndikuar pozitivisht në deklarimin e pagës reale dhe në rritjen e pagesës së kontributeve. Sipas të dhënave nga Administrata Tatimore, 143,126 punonjës kanë përfutur rritje të pagës me më shumë se 10% krahasuar me shtator 2024, ndërsa është rritur me 28% më shumë pagesa për kontributet dhe Tatimin mbi të Ardhurat nga Paga (TAP), krahasuar me shtator 2024. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve do të vijojë luftën kundër informalitetit të Pagave, për të mos i mohuar asnjë qytetari në Republikën e Shqipërisë të drejtën për pension të merituar!

LEXO MË SHUMË



sukses testimet për 4 shërbime të reja doganore të cilat do të ofrohen online nëpërmjet platformës E-Albania. Shërbimet e reja që do të ofrohen online së shpejti janë: Kërkesë për shtesa/ndryshime në Autorizimin e Regjimit të Përpunimit Pasiv; Aplikim për përjashtim nga rregulli i kompetencës territoriale; Kërkesë për

LEHTËSIMI I KLIMËS SË BIZNESIT, DOGANAT DO TË OFROJNË 4 SHËRBIME TË REJA ONLINE NË E-ALBANIA

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ka realizuar me

shtesa/ndryshime në Autorizimin e Regjimit të Magazinës Doganore, si dhe Kërkesë për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga një mbajtës tek një tjetër të Autorizimit për RPA. Nga ana tjetër, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me AKSHI-n dhe UNCTAD ka zhvilluar disa projekte që synojnë digjitalizimin e procedurave doganore në funksion të rritjes së transparencës, rritjes së efektivitetit, uljes së kostos dhe kohës së biznesit.

LEXO MË SHUMË

EMTOHET PËR HERË TË PARË INSTRUMENTI OBLIGACIONE 20-VJEÇARE ME KUPON FIKS, INTERES I LARTË NGA INVESTITORËT

Ministria e Financave emtoi për herë të parë në tregun e brendshëm instrumentin financiar afatgjatë Obligacione 20-vjeçare me kupon fikse, në datën 28 Janar 2025. Ministria ofroi për këtë instrument 1.50 miliardë lekë, ku kërkesa e tregut ishte 4.26 miliardë lekë (me një raport mbulimi prej 2.84 herë), duke evidentuar një performancë shumë të mirë të këtij instrumenti në tregun e letrave me vlerë të qeverisë si dhe reflektuar besimin e tregut në

stabilitetin dhe potencialin e tij financiar për një periudhë afatgjatë. Në vijimin e trendit rënës të yield-it për instrumentet afatmesëm dhe afatgjatë të qeverisë, Kuponi që do të paguajë Ministria e Financave për këtë instrument është 6.78%, çka rezulton në një situatë të favorshme përsa i përket shpenzimeve dhe kostos së borxhit shtetëror. Kategoritë kryesore të investitorëve në emetimin e Obligacioneve 20-vjeçare ishin: sistemi bankar; kategoria individë (Jokonkurrues dhe Konkurrues) dhe kategoria Fonde Investimi dhe Fonde Pensioni. Vlen të theksohet interesi i lartë i shfaqur edhe nga investitorët e huaj në tregun e brendshëm për këtë instrument.

LEXO MË SHUMË

